



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

Raporti i indikatorëve makroekonomik të Kosovës 2013 – 2017

Me projeksione për periudhën 2018-2021

**Departamenti i Integritimit European, Koordinimit të Politikave dhe Zhvillimit
Ekonomik**
Divizioni i Strategjive Kombëtare

Nëntor 2018

Lista e tabelave:

Tabela 1.Komponentët e BPV-së në Kosovë 2013-2017 (mil.€)	7
Tabela 2.Pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike në BPV (%)	9
Tabela 3.BPV për kokë banori në vendet e rajonit gjatë vitit 2017	14
Tabela 4.Projeksionet e BPV	14
Tabela 5.Borxhi i Përgjithshëm 2013 – 2017 (mil. €).....	15
Tabela 6.Eksporti dhe importi i mallrave të Kosovës 2013-2017 (mil. €)	17
Tabela 7.Eksporti dhe importi i mallrave sipas seksioneve 2013-2017 (mil. €)	19
Tabela 8.Eksporti dhe importi i shërbimeve të Kosovës 2013-2017 (mil. €).....	20
Tabela 9.Partnerët kryesorë të Kosovës në eksport 2013-2017 (mil. €)	21
Tabela 10.Partnerët kryesorë të Kosovës në import 2013-2017 (mil. €)	21
Tabela 11.Projeksionet e eksportit dhe importit për vitet 2018-2020 (mil. €)	22
Tabela 12.Remitancat 2013 - 2017 (mil. €)	24
Tabela 13.Vendet kryesore nga të cilat vijnë remitancat në %	24
Tabela 14.Investimet e huaja direkte në Kosovë 2013-2017	26
Tabela 15.Investimet neto sipas shteteve (mil. €)	28
Tabela 16.Indikatorët e performancës “Doing business 2018”	30
Tabela 17.Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) në %	31

Lista e figurave:

Figura 1.Bruto Produkti Vendor 2013-2017 (në mil.€).....	5
Figura 2.Komponentët kryesor të BPV-së 2013-2016 në %	7
Figura 3.Norma Reale e Rritjes së BPV (2013-2017).....	10
Figura 4.Projeksionet e rritjes ekonomike për shtetet e Ballkanit Perëndimor në %	12
Figura 5.BPV për kokë banori në Kosovë 2013-2017	13
Figura 6.Borxhi Publik si % e BPV në vendet e rajonit 2013 – 2016.....	16
Figura 7.Tregtia e jashtme në mallra (mil. €).....	18
Figura 8.Tregtia e jashtme në shërbime (mil. €)	20
Figura 9.Projeksionet e tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime (mil. €).....	22
Figura 10.Investimet e huaja direkte në Kosovë 2013-2017.....	26
Figura 11.Struktura e investimeve në përqindje.....	27
Figura 12.Investimet në vitet 2013-2017 sipas shteteve	29
Figura 13.Ndikimi i IHD në BPV si përqindje.....	29

Lista e shkurtesave:

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB – Banka Botërore
BE – Bashkimi Europian
BK – Buxheti i Kosovës
BPV – Bruto Produkti Vendor
BQK – Banka Qendrore e Kosovës
BRE – Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CEFTA – Central European Free Trade Agreement
DSKZHE – Divizioni i Strategjive Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik
EJL – Europa Juglindore
FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
IH K – Indeksi i Harmonizuar imimeve të Konsumit
IHD – Investimet e Huaja Direkte
KASH – Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
MF – Ministria e Financave
MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik
PFB – Pariteti i Fuqisë Blerëse
SDR – Special Drawing Right
SHPRrV - Shkalla e Përbërë e Rritjes Vjetore
UNDP – United Nations Development Programme

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
1 Bruto Produkti Vendor.....	5
1.1 Bruto Produkti Vendor dhe rritja ekonomike në Kosovë.....	5
1.1.1 Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve	6
1.1.2 Pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike në Bruto Produktin Vendor.....	9
1.1.3 Norma reale e rritjes së BPV-së	10
1.2 Rritja ekonomike në vendet e rajonit (EJL)	11
1.3 Bruto Produkti Vendor për kokë banori në Kosovë	12
1.4 Projektionet për Bruto Produktin Vendor	14
2 Borxhi Publik.....	15
2.1 Borxhi Publik në vendet e rajonit dhe BE-së	16
3 Shkëmbimet tregtare.....	17
3.1 Tregtia në mallra.....	17
3.2 Tregtia në shërbime.....	20
3.3 Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës.....	21
3.4 Projektionet e shkëmbimeve tregtare 2018-2020.....	22
4 Remitancat.....	23
5 Investimet e Huaja Direkte.....	26
5.1 IHD sipas sektorëve.....	27
5.2 Investimet sipas shteteve.....	28
6 Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK)	31
7 Konkluzion.....	32
8 Referencat.....	34
Aneks.....	35

HYRJE

Institucione të ndryshme qeveritare, jo-qeveritare dhe ndërkombëtare, publikojnë të dhëna të treguesve ekonomik për të analizuar gjendjen ekonomike të Kosovës. Divizioni i Strategjive Kombëtare për Zhvillim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara në Rregullore të brendshme, përgatit periodikisht dhe publikon analiza të treguesve ekonomik për zhvillimin ekonomik nacional dhe sektorial. Bazuar në të dhëna, analiza dhe publikime të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës, Ministrisë së Financave, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe Eurostat, ka përgatitur analizën e indikatorëve kryesorë të ekonomisë së Kosovës.

Qëllimi i këtij raporti është paraqitja dhe krahasimi i parametrave makroekonomik të Kosovës nga një perspektivë rajonale, duke nënvizuar rëndësinë e tyre në ekonominë vendore dhe duke ofruar analiza krahasimore me shtetet e rajonit të Europës Juglindore gjatë periudhës 2013-2017. Ky raport ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të ekonomisë së Kosovës përmes sintetizimit të të dhënave, raporteve dhe hulumtimeve të institucioneve relevante vendore dhe ndërkombëtare. Duke marrë parasysh procesin e integritimit europian në të cilin gjendet Kosova, dhe gjithashtu bashkëpunimin rajonal në kuadër të ‘Regional economic area’ është konsideruar e nevojshme të bëhet krahasim me vendet e rajonit, të cilat kalojnë në faza të ngjashme dhe njëkohësisht me disa nga shtetet anëtare të BE-së, të anëtarësuara së fundi. Për më shumë, ky raport ofron mundësi për analiza më të gjera në fushat e caktuara, të cilat do të mund të përdoren në të ardhmen për të adresuar pyetje rreth politikave publike, përfshirë politikat fiskale si dhe shërben për qëllime edukativo-arsimore (për studentët dhe hulumtuesit e rinj).

Për të paraqitur gjendjen e ekonomisë së Kosovës dhe përgatitjen e këtij raporti është bërë hulumtim sekondar në historikun e disa treguesve kyç, duke përdorur të dhënat e fundit të publikuara, përfshirë: bruto produktin vendor, rritjen ekonomike, borxhin publik, shkëmbimet tregtare, remitancat, investimet e huaja direkte dhe indeksin e çmimeve të konsumit. Secili nga këta tregues është paraqitur në periudhë pesë-vjeçare, duke analizuar trendin e tyre, arsyet se çfarë ka ndikuar në këto trende specifike dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Poashtu, për të bërë një analizë më të mirë krahasimore të këtyre indikatorëve, në raport janë përfshirë edhe të dhëna për vendet e Europës Juglindore. Pjesë të rëndësishme të raportit përbëjnë dhe projeksionet të periudhës afatmesme 2018-2021 të cilat janë paraqitur për disa nga indikatorët të përmbledhur në analizën makroekonomike.

1 BRUTO PRODUKTI VENDOR

Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik i llogarive kombëtare, i cili paraqet performancën ekonomike të një shteti në një periudhë të caktuar. BPV gjithashtu është një matës agregat i vlerave të të gjitha produkteve dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një ekonomi. Andaj, është e rëndësishme që BPV të matet për të gjykuar gjendjen e një ekonomie dhe dinamikën e saj.

Për shkak të kualitetit më të mirë të të dhënave në fushën e shpenzimeve dhe faktit që Kosova në fushën e prodhimit ka mungesë të të dhënave ekonomike për analiza dhe vlerësime të BPV-së, institucionet përdorin BPV-në të llogaritur sipas metodës së shpenzimeve. Bruto produkti vendor sipas qasjes së shpenzimeve është shuma e të gjitha shpenzimeve finale të mallrave dhe shërbimeve.

Bruto Produkti Vendor është shuma e vlerës së shtuar bruto (me çmime blerëse) nga të gjithë prodhuesit rezidentë në ekonominë vendore, përfshirë çdo tatim të produktit duke zbritur subvencionet që nuk përfshihen në vlerën e produkteve.


(Banka Botërore)

1.1 Bruto Produkti Vendor dhe rritja ekonomike në Kosovë

Ekonomia e Kosovës në dekadën e fundit ka shënuar normë pozitive të rritjes ekonomike, përkundër sfidave të shkaktuara nga luhatjet në ekonominë globale dhe sidomos në atë Europiane. Ekonomia kosovare është rritur vazhdimisht mbi mesataren e Ballkanit Perëndimor në periudhën e krizës financiare globale, megjithëse nga një bazë e ulët. Modeli i rritjes është mbështetur kryesisht në remitanca dhe asistencë nga donatorët për të lehtësuar konsumin e brendshëm, por gjithashtu edhe në investime publike në infrastrukturë.

Në figurën në vijim është paraqitur trendi i BPV-së së Kosovës për periudhën 2013-2017

Figura 1. Bruto Produkti Vendor 2013-2017 (në mil.€)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Nëntor, 2018)

BPV në Kosovë në vitet 2013-2017 përkundër krizës globale ka pasur një trend progresiv. Në vitin 2013, BPV kishte vlerën 5,232.8 milion Euro dhe ka vazhduar të rritet vazhdimisht deri në vitin 2017 duke arritur vlerën prej 6,326.6 milion Euro¹.

1.1.1 Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve

Komponentët kryesorë të BPV-së sipas metodës së shpenzimeve janë: shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake, shpenzimet e konsumit final të Qeverisë, formimi i bruto kapitalit (investimet) dhe eksporti neto. Gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare vërehet një trend rritës në të gjithë komponentët, me përjashtim të shpenzimeve të konsumit të Qeverisë që janë mesatarisht konstante. Shpenzimet e konsumit të ekonomive shtëpiake prej vitit 2013 kanë pasur një rritje mesatare vjetore rreth 3.87%, investimet rreth 4.7%, eksporti rreth 15.8%, dhe importi rreth 5.7%. Siç është shfaqur në tabelën 1 më poshtë, kategoria e formimit të bruto kapitalit pësoi një rënie në vitin 2014, duke pasuar me ngritje prej rreth 14% në krahasim me periudhën paraprake, si rezultat i rritjes së nivelit të investimeve. Përmirësim ka pasur edhe në kategorinë e eksportit të mallrave, si rezultat i ngritjes së çmimeve bazike të metalit dhe zgjerimit të gamës së produkteve të eksportuara (produkte bimore, kimike dhe minerare)². Gjithashtu, në këtë rritje ndikoi edhe rritja e eksportit në shërbime, më konkretisht shërbimet kompjuterike me rritje vjetore prej 19.5% dhe shërbimet e udhëtimit me rritje vjetore prej 33.5%³.

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018), Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017

² Banka Botërore, Kosovo Overview (2018) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme 2017

³ Banka Qendrore e Kosovës, Raporti Vjetor 2017

Ndikimi pozitiv i rritjes së eksporteve mund të shihet në zvogëlimin e deficitit tregtar në vitin 2017, ku në krahasim me vitin 2016, u ul për 12.7%.

Tabela 1. Komponentët e BPV-së në Kosovë 2013-2017 (mil.€)

Komponentët						
Viti	Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake (1)	Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (2)	Formimi i bruto kapitalit (3)	Eksporti neto (4=5-6)	Eksporti (mallra dhe shërbime) (5)	Importi (mallra dhe shërbime) (6)
2013	4,548.3	869.6	1,460.2	(1,665.2)	944.7	2,609.9
2014	4,881.6	842.3	1,397.9	(1,748.8)	1,081.9	2,830.7
2015	5,113.3	851.2	1,596.5	(1,795.2)	1,119.1	2,914.3
2016	5,267.0	837.8	1,721.3	(1,809.5)	1,304.3	3,113.8
2017	5,289.3	849.2	1,742.2	(1,578.3)	1,679.5	3,257.8


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018)

*Me çmime konstante

Përkundër të dhënave që tregojnë se deficitit tregtar si vlerë është ulur në vitin 2017, nëse analizohet si komponentë e BPV-së në përqindje, mund të shihet se ende ka ndikim negativ, mirëpo më të vogël në krahasim me vitet tjera. Ky deficit i bilancit tregtar vjen si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të importeve në mallra dhe rritjes më të ngadalësuar të eksportit të mallrave.

Sipas figurës 2 më poshtë, komponent kryesor i BPV-së për periudhën 2013-2017 vazhdon të jetë kategoria e shpenzimeve të konsumit final të ekonomive shtëpiake, me një mesatare rreth 85%. Përqindja më e ulët ishte në vitin 2013 (83.5%) ndërsa më e larta në vitin 2014 (86.3%).

Figura 2. Komponentët kryesor të BPV-së 2013-2017 në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raporti vjetor i Bruto Produktit Vendor (2018)

Komponenti i dytë me përqindje në strukturën e BPV-së është formimi i bruto kapitalit (investimet), me një mesatare rreth 27%. Ky komponent nuk ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare. Komponent i fundit me përqindje në strukturën e BPV-së janë shpenzimet e konsumit final të Qeverisë. Kjo përqindje ishte më e larta në vitin 2014, 16.4% e BPV-së, ndërsa më e ulëta në vitin 2017, 13.4% e BPV-së.

Nga vlerat e përmendura më lartë, konsumi i përgjithshëm mbetet komponenti kryesor i BPV-së dhe gjatë periudhës 2013-2017 nuk ka pësuar ndryshime. Ndërsa, investimet kanë pësuar ulje për 1.8% në vitin 2014, dhe më pas ngritje në tri vitet e ardhshme. Sipas BQK-së, ngritja e investimeve në vitin 2015 u ndikua nga rritja e investimeve të huaja direkte dhe nivelit të kredive të reja investuese. Si pasojë e rritjes së komponentit të investimeve, përqindja e ndikimit të formimit të bruto kapitalit në BPV ka arritur në 28.4%.

1.1.2 Pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike në Bruto Produktin Vendor

Aktivitetet ekonomike kryesore të cilat kanë kontribuar në rritjen e BPV-së në periudhën 2013-2017 ishin: tregtia me shumicë dhe pakicë, industria përpunuese, bujqësia, gjuetia, pylltaria, peshkimi, afarizmi me pasuri të patundshme, si dhe administrimi publik dhe i mbrojtjes. Në tabelën 2 është paraqitur pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike me përqindje në BPV.

Tabela 2.Pjesëmarrja e aktiviteteve ekonomike në BPV (%)

Aktivitetet ekonomike	2013	2014	2015	2016	2017
Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	12	11.9	10.3	10.5	9.1
Industria nxjerrëse (minierat dhe guroret)	2.2	2.1	2	2.1	2.3
Industria përpunuese	11	10.3	10.8	11	10.9
Furnizimi me energji elektrike, me gaz dhe me ujë	3.7	3.6	4.1	4.2	4.4
Ndërtimtaria	6.6	6	6.8	6.5	8.0
Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	12.3	12.4	12.3	12.3	12.5
Transporti, magazinimi	4.4	3.5	3.6	3.6	3.7
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	4	4	3.7	2.9	3.1
Afarizmi me pasuri të patundshme	8.9	9	8.6	8	7.6
Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	9.3	9	7.8	7.7	7.4
Edukimi	3.1	3.9	4	4	3.8
Veprimtaritë tjera shoqërore sociale, të shërbimeve dhe personale	5.7	7.3	7.6	7.6	7.7
Gjithsej	83.3	82.9	81.6	80.4	80.5
Tatimet në produkte	16.7	17.1	17.9	20.1	20.3
Bruto Produkti Vendor	100	100	100	100	100

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Nëntor, 2018)

Në periudhën 2013-2017, tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave mbetet aktiviteti që kontribon me vlerën më të lartë në BPV, me 12.4% mesatarisht. Poashtu vlera e shtuar e aktivitetit ekonomik në sektorin e bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe peshkimit me rreth 11%, thekson rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e Kosovës edhe pse me tendencë rënëse në vitet e fundit. Për më shumë, një pjesëmarrje të konsiderueshme ka edhe sektori i industrisë përpunuese, rreth 11%. Në këtë periudhë të vëzhguar, vlerën me tendencë rritëse tek komponenti i BPV ka tatimi më produkte


duke shënuar 16.7% ndikimi në vitin 2013, ndërsa në vitin 2017 tatimi në produkte ka arritur në 20.3% ndikimi në BPV.

1.1.3 Norma reale e rritjes së BPV-së

Norma reale e rritjes së BPV-së ka pësuar disa ndryshime gjatë periudhës 2013-2017. Krahasuar me periudhën paraprake vërehet trendi rritës në vitin 2013, ku norma reale e rritjes ishte 3.4%. Kjo normë ka pësuar rënie në 1.2% në vitin 2014, kryesisht si pasojë e jo-stabilitetit politik në shtet (investimet e përgjithshme janë karakterizuar me rënie për shkak të rënies së investimeve publike⁴) por në dy vitet e ardhshme është ngritur në 4.1%. Në vitin 2017 rritja reale e BPV ka qenë 4.2%, apo rritja më e lartë në periudhën e vëzhguar dhe trendi pozitiv i rritjes ekonomike pritet të vazhdojë edhe në periudhën afatmesme.

Këto të dhëna janë të shfaqura në figurën 3 më poshtë:

Figura 3. Norma Reale e Rritjes së BPV (2013-2017)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Shtator, 2018)

Sipas këtyre të dhënave, rritja mesatare ekonomike në Kosovë për periudhën 2013-2017 ishte 3.4%. Norma më e lartë e rritjes gjatë kësaj periudhe ishte në vitin 2017, duke ndjekur trendin rritës të vitit 2015 dhe 2016 (4.1%), ndërsa norma më e ulët ishte në vitin 2014 (1.2%). Kjo normë e ulët e rritjes ekonomike në vitin 2014 ishte si pasojë e jo-stabilitetit politik, që shkaktoi pasiguri edhe tek agjentët ekonomik dhe rrjedhimisht mungesë të aktiviteteve ekonomike. Rënia e nivelit të aktivitetit ekonomik më së shumti është vërejtur në uljen e investimeve publike, në krahasim me periudhat tjera. Në këtë vit, përkundër stagnimit në indikatorët tjerë, vërehet rritje e eksporteve dhe diversifikim i mallrave të

⁴ Raporti Vjetor 2014, Banka Qendrore e Kosovës

eksportuara. Kategoria e produkteve të metalit filloi të zëvendësohet me prodhime të drurit, plastikës dhe produkte ushqimore.

Në vitin 2015 është shënuar rritje ekonomike mjaft e lartë në krahasim me vitin paraprak, e cila erdhi si rezultat i shpenzimeve të larta kapitale, veçanërisht në infrastrukturë. Gjithashtu, ndikimi në rritje ekonomike në vitin 2015 ka ardhur edhe si pasojë e ndryshimeve tatimore që mundësuan lehtësira për prodhuesit vendor (pako fiskale 1.0). Norma e BPV-së vazhdoi të rritet në vitet 2016 dhe 2017, në të cilat ndikim pati rritja e investimeve private dhe publike si dhe rritja e eksportit të shërbimeve.⁵

Në krahasim me vendet europiane, Kosova ka vazhduar të ketë qëndrueshmëri ekonomike me normat reale të rritjes ndër më të lartat në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe rreth 2.5% mbi performancën e shteteve anëtare të reja të BE-së. Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme (konsumit) dhe rritjes së investimeve kapitale, reflektuar edhe nga remitancat⁶. Kriza ekonomike botërore ka pasur ndikim më të vogël në ekonominë vendore për shkak të shkallës së ulët të integritimit të Kosovës në tregjet ndërkombëtare.

1.2 Rritja ekonomike në vendet e rajonit (EJL)

Ngjajshëm me Kosovën, edhe shtetet e tjera të Europës Juglindore (EJL) kanë pasur rritje pozitive ekonomike gjatë kësaj periudhe, megjithëse në një normë më të ulët se Kosova. Në vitin 2017, mesatarja e normës së rritjes ishte 2.9%, ku Kosova dhe Mali i Zi kryesojnë me normën më të lartë, prej 4.2% dhe 4.3%. Ndërsa shteti me përqindjen më të ulët të rritjes ishte Maqedonia me 0%. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, rritja ekonomike në këto shtete ishte më e ngadalësuar gjatë vitit 2017. Në rastin e Maqedonisë kjo ndodhi për shkak të jo-stabilitetit politik në vend, ndërsa në Serbi për shkak të motit të ftohtë që pati ndikim në produktet bujqësore dhe sektorin e ndërtimitarisë. Në Kosovë, Shqipëri dhe Mal të Zi rritja ishte më e lartë përkrahur nga rritja ekonomike e partnerëve tregtarë, ngritja e çmimeve bazë të mallrave dhe zbatimi i projekteve të mëdhenj investues.⁷

Për periudhën 2018-2021 rritja mesatare reale në Kosovë projektohet të jetë rreth 5.0%

Parashikimet e Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore për vitet 2018 dhe 2019, paraqesin rritje progresive për Kosovën, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Maqedoninë, ndërsa ulje në normën e rritjes ekonomike për Shqipërinë dhe Malin e Zi. Norma më e lartë sërish pritet të


⁵ Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2018

⁶ Banka Botërore (2018), Kosovo Overview

⁷ Banka Botërore, Western Balkans Regular Economic Report: Spring 2018

jetë në Kosovë, që sipas projeksioneve do të arrijë deri në 4.9% në vitin 2019. Kjo do të jetë si rezultat i rritjes së investimeve, konsumit dhe rritjes së kërkesës për produkte dhe shërbime nga shtetet e Eurozonës (eksporteve). Në Mal të Zi parashikohet që norma e rritjes ekonomike në vitin 2019 të jetë 2.8%, pasi që pritet të ketë ulje të konsumit të përgjithshëm për arsye të konsolidimit fiskal⁸. Ndërsa në Maqedoni pritet një rikuperim i situatës ekonomike pas zgjidhjes së çështjeve të brendshme politike, dhe rritja është projektuar të arrijë në 2.9% në vitin 2019.

Figura 4. Projektionet e rritjes ekonomike për shtetet e Ballkanit Perëndimor në %



Burimi: Ministria e Financave (2018), KASH 2019-2021, Agjencia e Statistikave të Kosovës (Kosova) dhe Banka Botërore (Nëntor, 2018)

Në rastin e Serbisë, pritet të rriten komponentët e konsumit dhe investimeve ndërsa përmirësime pritet të ketë edhe në prodhimtarinë bujqësore. Për arsye të konsolidimit fiskal, në Mal të Zi pritet të ketë ulje të konsumit të përgjithshëm⁹.

1.3 Bruto Produkti Vendor për kokë banori në Kosovë


BPV për kokë banori është indikator i të hyrave totale të gjeneruara nga aktiviteti ekonomik i një vendi, dhe shpesh përdoret si matës i mirëqenies materiale të banorëve të një vendi. Indikator i cili përdoret nga institucionet ndërkombëtare për matjen e fuqisë blerëse është Pariteti i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity, PPP) i cili mat sasinë e nevojshme të një valute për të blerë shportën e produkteve dhe shërbimeve të konsumatorit. Në Kosovë ende nuk ka filluar matja e Paritetit të Fuqisë Blerëse, prandaj në këtë raport përdoret BPV për kokë banori.

⁸ Konsolidimi fiskal në Mal të Zi do të përfshijë përforcimin e stabilitetit fiskal, krijimin e suficitit buxhetor dhe përcaktimin e trendit rënës të borxhit publik nga viti 2019 (Montenegro Fiscal Strategy 2017-2020)

⁹ Ibid

BPV për kokë banori në Kosovë ka pasur trend rritës, nga 2,935 Euro në vitin 2013, ka arritur në 3,566 Euro në vitin 2017. Sidoqoftë, vlera e BPV për kokë banori në Kosovë mbetet në suazat e vendeve në zhvillim, krahasuar me BPV-në mesatare në shtetet e Bashkimit Europian dhe vendet e tjera të zhvilluara¹⁰.

Figura 5. BPV për kokë banori në Kosovë 2013-2017



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Nëntor 2018)

Përkundër rritjes së BPV për kokë banori nga 2,935 Euro në 3,566 Euro gjatë periudhës 2013-2017, Kosova kategorizohet si 'low-middle income country'¹¹. Gjatë kësaj periudhe referuese 2013-2017, rritja më e lartë vjetore ishte prej vitit 2014 në vitin 2015, përkatësisht në vlerë prej 6.2%. Norma e rritjes së BPV për kokë banori është më e madhe në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit, indikator ky i cili tregon se Kosova ka trend rritës më të shpejtë sesa vendet tjera në zhvillim. Poashtu, me këtë nivel të rritjes Kosova do të mund të arrijë më shpejtë vendet e zhvilluara sesa shtetet tjera, të cilat janë në nivel të njëjtë të zhvillimit me Kosovën.

Në krahasim me vendet e rajonit si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, Kosova ka BPV për kokë banori më të ulët. BPV-në për kokë banori më të lartë nga vendet e rajonit por që janë anëtare të Bashkimit Europian e ka Bullgaria me 7,414 Euro, Rumania me 9,981 Euro dhe Kroacia e cila në vitin 2017 sipas Bankës Botërore kishte BPV për kokë banori prej 12,271 Euro (Tabela 3).

¹⁰ Eurostat (2017), GDP per capita, consumption per capita and price level indices.

¹¹ Sipas Bankës Botërore, vendet me të ardhura të mesme të ulëta konsiderohen ato shtete të cilat kanë BPV për kokë banori në kufirin \$996 - \$3,895.

Tabela 3. BPV për kokë banori në vendet e rajonit gjatë vitit 2017

	Kosova	Shqipëria	Maqedonia	Serbia	Mali i Zi	Bulgaria	Rumania	Kroacia
EUR ¹²	3,566	4,188	5,024	5,446	7,079	7,414	9,981	12,271

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Nëntor 2018) dhe Banka Botërore (Nëntor, 2018)

1.4 Projektionet për Bruto Produktin Vendor

Në projektionet për periudhën 2018-2021 për BPV, parashihet trend i vazhdueshëm i rritjes së BPV-së, duke arritur vlerën 8,007 milion euro në vitin 2021. BPV parashihet të ketë konsumin privat një nga komponentët kryesorë shtytës të rritjes, të pasuar nga investimet publike dhe private dhe eksporti. Sipas parashikimeve të Ministrisë së Financave për këtë periudhë katër vjeçare, investimet totale mesatare do të kenë rritje reale prej 8.1%, ndërsa eksporti prej 3.7%. Shtytës i rëndësishëm i rritjes së investimeve do të jenë shpenzimet kapitale qeveritare, që pritet të përbëjnë rreth 11.1% të BPV-së. Kjo rritje vjen si rezultat i implementimit të ‘Klauzolës së Investimeve’ që mundëson financimin e projekteve kapitale nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë zhvillimore, mbi deficitin prej 2% të BPV-së¹³. Gjatë periudhës 2018-2021 pritet që rritja reale e BPV-së të jetë më e lartë, duke filluar prej 4.6% në vitin 2018, pasuar nga 4.9% në vitin 2019, 5.1% në vitin 2020 dhe 5.3% në vitin 2021. Sipas këtyre parashikimeve, rritja reale mesatare për këtë periudhë pritet të jetë 5.0%. Ky trend rritës është bazuar në pritshmëritë pozitive të rritjes së investimeve dhe eksporteve dhe vendos Kosovën në vendin e parë për sa i përket rritjes ekonomike, krahasuar me shtetet e rajonit.

Tabela 4. Projektionet e BPV

Viti	2018	2019	2020	2021
Bruto Produkti Vendor (mil.€)	6,673	7,066	7,539	8,007
Norma Reale e Rritjes së BPV (%)	4.6%	4.9%	5.1%	5.3%
BPV për kokë banori (€)	3,727	3,931	4,180	4,425

Burimi: Ministria e Financave, KASH 2019-2021 (Prill, 2018)

¹² Norma mesatare vjetore e këmbimit valutor EUR = 0.923 USD

¹³ Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021

2 BORXHI PUBLIK

Sipas Ligjit për Borxhet Publike Nr. 03/ L–175, borxhi publik (shtetëror) definohet si borxh i marrë nga qeveria qendrore, të cilin Republika e Kosovës është e obliguar ta paguajë, por nuk do të përfshijë asnjë detyrim të entiteteve të tjera të caktuara qeveritare, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në komuna, ndërmarrje publike, apo Bankën Qendrore të Kosovës. Sipas po të njëjtit Ligj, arsyet për të cilat Kosova mund të hyjë në borxh publik janë për të: financuar deficitin e borxhit shtetëror; financuar projekte investuese; ri-financuar borxhin shtetëror të kontraktuar më herët; pagesës në formë të garancisë shtetërore; shpenzimet e ndërlydhura me një emergjencë kombëtare të shpallur nga Kuvendi dhe tjera.¹⁴

Kosova vazhdon të ketë nivel të ulët të borxhit publik, krahasuar me vendet e rajonit dhe ato të Eurozonës por tendenca e rritjes së këtij borxhi është e madhe. Në vitin 2013 borxhi i përgjithshëm i vendit ishte 476.27 milion euro apo 8.94% e BPV, nga të cilat 323.76 milion euro janë borxh ndërkombëtar ndërsa 152.51 milion euro borxh i brendshëm. Deri në vitin 2017 borxhi i përgjithshëm është ngritur në 996.42 milion euro apo 16.63% e BPV, pra vetëm në 4 vite borxhi publik i Kosovës është rritur për më shumë se 100 përqind.

Tabela 5. Borxhi i Përgjithshëm 2013 – 2017 (mil. €)

	2013	2014	2015	2016	2017
Borxhi Ndërkombëtar	323.76	326.35	371.17	373.77	422.15
Niveli Qendror	321.73	316.54	339.87	323.93	365.18
Nën-Huazimet	2.03	9.81	31.3	49.83	56.97
Komunat	-	-	-	-	-
Borxhi i Brendshëm Bruto	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27
Niveli Qendror	152.51	256.52	377.78	478.97	574.27
Komunat	-	-	-	-	-
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	476.27	582.87	748.95	852.74	996.42
Garancitë shtetërore	-	10	10	20	44
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm si % e BPV	8.94%	10.65%	13.07%	14.58%	16.63%

Burimi: Ministria e Financave, Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm – tremujori i katërt 2017

¹⁴ Ligji Nr. 03/ L–175 për Borxhe Publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës


Në vitin 2017, nga totali i borxhit prej 996.42 milion euro, 574.27 milion euro ishin borxh i brendshëm ndërsa 422.15 milion euro ishin borxh ndërkombëtar. Portofoli i borxhit ndërkombëtar në vitin 2017 është 67% në valutën Euro dhe 33% është në SDR¹⁵. Nga totali i borxhit ndërkombëtar, 62% është borxh i huazuar me normë fikse të interesit dhe 32% është borxh i huazuar me normë variabile të interesit.¹⁶

Borxhi i brendshëm sipas mbajtësve të letrave me vlerë në vitin 2017 ishte 42% ndaj bankave, 18% ndaj fondeve pensionale, 35% ndaj institucioneve publike, 4% ndaj kompanive të sigurimeve dhe 1% ndaj të tjerëve.¹⁷

2.1 Borxhi Publik në vendet e rajonit dhe BE-së

Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova ka nivel dukshëm më të ulët të borxhit publik. Borxhi publik në Shqipëri në vitin 2017 ishte 67.8% e BPV, Mal të Zi 65.1%, Serbi 57.7%, Maqedoni 39.3% dhe Bosnie dhe Hercegovinë 36.1%. Bazuar në këto informata, vërehet se Shqipëria ka borxhin më të lartë publik në rajon.

Figura 6. Borxhi Publik si % e BPV në vendet e rajonit 2013 – 2017



Burimi: Banka Botërore (2018) e Ministria e Financave (Nëntor 2018)

¹⁵ SDR është një 'shportë' monedhash e cila përbëhet nga monedhat si në vijim: EUR, USD, GBP, JPY dhe CNY. Vlera e SDR përcaktohet në bazë të një mesatare e cila është e tërhequr nga vlerat e monedhave të përmendura më lartë.

¹⁶ Ministria e Financave, Programi i borxhit shtetëror 2019-2021, Nëntor 2018

¹⁷ Ibid

Vendet Europiane me borxhin publik më të lartë si % të BPV-së gjatë vitit 2017 janë: Greqia me borxh publik prej 176.1%, Italia 131.2%, Portugalia 124.8%, Belgjika 103.4%, dhe Franca 98.5%. Borxhi Publik në Eurozonë (19 shtete) në vitin 2017 ishte 86.8% e BPV ndërsa në vendet e Bashkimit European (28) ishte 81.6% e BPV-së.¹⁸ Borxhi publik më i lartë mesatar në Eurozonë është regjistruar në vitin 2014 duke arritur në 91.9% të BPV-së ndërsa më i ulëti mesatar është regjistruar në vitin 2007 në vlerë prej 64.9% të BPV-së.

3 SHKËMBIMET TREGTARE

Gjatë viteve 2013-2017, Kosova ka pasur rritje të qëndrueshme të eksportit të mallrave, nga 294 milion euro në 378 milion euro, duke shënuar rritje të përbërë vjetore prej 5.17%¹⁹. Në anën tjetër, Kosova ka pasur bilanc tregtar negativ, si rezultat i rritjes substanciale të importeve në krahasim me rritjen marginale të eksporteve gjatë periudhës së vëzhguar, prandaj deficiti tregtar është më i shprehur në tregti me mallra. Në eksportin e shërbimeve Kosova kishte rritje të vazhdueshme, më saktësisht nga 875 milion euro në vitin 2013 në 1,330 milion euro në vitin 2017.

3.1 Tregtia në mallra

Në tabelën 6 janë paraqitur vlerat e eksportit dhe importit të mallrave, bilanci tregtar, përqindja e ndryshimeve të eksportit, importit dhe bilancit tregtar për periudhën 2013-2017 krahasuar me vitin paraprak dhe përqindja e mbulimit të importit me eksport për këto vite.

Tabela 6. Eksporti dhe importi i mallrave të Kosovës 2013-2017 (mil. €)


Viti	Importi (mil. €)	Eksporti (mil. €)	Bilanci tregtar (mil. €)	Ndryshimi BT (t/t-1, në %)	Përqindja e mbulimit të Ex/Im
2013	2,449	293.8	-2,155		12.0
2014	2,538	324.5	-2,213.7	2.72	12.8
2015	2,634.7	325.2	-2,309.3	4.31	12.3
2016	2,789.4	309.6	-2,479.8	7.38	11.1
2017	3,047	378	-2,669	7.62	12.4

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (Shtator, 2018)

¹⁸ Eurostat, General Government Gross Debt (2018)

¹⁹ Llogaritur sipas formulës për shkallën e përbërë të rritjes vjetore (Compound Annual Growth Rate – CAGR), shih Aneks

Figura 7. Tregtia e jashtme në mallra (mil. €)



Gjatë periudhës 2013-2017, deficiti i bilancit tregtar ka pësuar rritje marginale në kategorinë e mallrave, prej 2,155 milion euro në 2,669 milion euro. Poashtu, vlen të përmendet që gjatë viteve 2013-2017, importet e mallrave janë rritur 4.46% sipas shkallës së përbërë të rritjes vjetore (ShPRrV), ndërsa ato të shërbimeve janë rritur për 5.31% ShPRrV. Në të njëjtën periudhë kohore, eksportet e mallrave janë rritur për 5.17% dhe ato të shërbimeve janë rritur për 13.26% ShPRrV, me proporcion pozitiv në të dyja kategoritë.

Nga viti 2013-2017, mbulimi i importit të mallrave me eksport ishte i ulët, përafërsisht 12 %, me përqindjen më të lartë të mbulimit në vitin 2014 me 12.8%. Në vitin 2017, mbulimi i importeve nga eksportet ishte 12.4% në kategorinë e mallrave, një rritje nga viti paraprak në të cilin kjo vlerë ishte 11.1%. Ndër sektorët më të rëndësishëm për eksport në vitin 2017 janë: sektori i bujqësisë, veçanërisht produktet bimore, me rritje të qëndrueshme prej 39.3%, kategoria e ushqimeve të përgatitura, pijeve, pijeve alkoolike dhe duhanit, me rritje prej 33.4% dhe metalet bazë dhe artikujt prej tyre me rritje prej 21.8%. Rritja e këtyre sektorëve kryesisht është nxitur nga marrëveshjet e favorshme tregtare me partnerët tregtarë, sidomos me vendet e BE-së.

Në analizën e detajuar të importit, vërehet qartë një gamë pothuajse e njëjtë e produkteve të importuara nga vendet e ndryshme në Kosovë nga viti në vit. Kategoria më e importuar e produkteve në vitet 2013-2017 ishin materialet e përpunuara dhe lëndët djegëse minerale (vajrat minerale dhe produktet). Në listën e produkteve tjera më të importuara janë: duhani, alkooli, mjete të ndryshme transporti, makineritë mekanike dhe pjesët e tyre si dhe makineritë elektrike dhe pjesët e tyre. Eksporti i Kosovës ka pasur

rritje konstante në këtë periudhë, mirëpo është ende në ngecje në krahasim me importin dhe si pasojë krijon bilanc negativ tregtar.

Tabela 7. Eksporti dhe importi i mallrave sipas seksioneve 2013-2017 (mil. €)

Eksporti/Importi	2013		2014		2015		2016		2017	
	Ex	Im	Ex	Im	Ex	Im	Ex	Im	Ex	Im
Ushqime dhe kafshë të gjalla	20.7	429.6	25.4	460	24.3	480.1	26.7	490.7	35.2	517.7
Pije dhe duhan	13.3	119.2	12.4	123.3	15.9	117.1	16.9	127.9	24.1	136.6
Materiale të përpunuara	73.8	63.6	77.6	65.2	56.1	67.3	68.9	51.6	92.5	69.5
Lëndë djegëse	22.5	412.3	17	400.1	21	337.4	32.4	279.2	35.3	381.2
Yndyrna bimore dhe shtazore	0.45	22.7	0.19	21.8	0.41	22.4	0.9	24.1	0.179	24.3
Produkte kimike	8.1	277.5	10.2	284	12.7	313.3	15.4	338.6	18.8	351.1
Mallra të përpunuara	129.4	520.6	153.8	510.3	153.7	557.2	104.5	596.1	117.4	631.4
Pajisje transporti	11.6	385.4	13.6	417.9	13.6	466.8	10.1	566.4	10.3	620.8
Mallra të tjera të përpunuara	13.9	216.2	14	252.4	22.3	269.9	34.1	311.9	39.7	311.6
Mallra të pa klasifikuara diku tjetër	0.143	1.8	0.54	2.8	5.3	2.8	0.171	2.5	4.1	2.4
Gjithsej	293.8	2,449	324.5	2,538.3	325.2	2,634.6	310.1	2,789.4	378	3,047.2
Gjithsej Balanci	-2,155.2		-2,213.7		-2,309.3		-2,479.8		-2,669.2	

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018)

3.2 Tregtia në shërbime


Në kategorinë e shërbimeve, përqindja e mbulimit të importeve nga eksportet është pozitive dhe në vitin 2017 arrin vlerën 248 %, e shtyrë kryesisht nga rritja prej 23% në kategorinë e udhëtimeve. Shërbimet e udhëtimit njëkohësisht përbëjnë 63.3% të totalit të shërbimeve të eksportuara. Mallrat dhe shërbimet qeveritare si dhe shërbimet tjera të biznesit janë dy kategori tjera të cilat kanë ndikuar pozitivisht në bilancin pozitiv të rritjes së eksportit të shërbimeve në vitin 2017. Bilanci i shërbimeve në periudhën 2013-2017 ka shënuar rritje nga 875 milion euro në vitin 2013, në 1,330 milion euro në vitin 2017.

Tabela 8. Eksporti dhe importi i shërbimeve të Kosovës 2013-2017 (mil. €)

Viti	Import (mil. €)	Eksport (mil. €)	Bilanci Tregtar (mil. €)	Ndryshimi BT (t/t-1, në %)	Përqindja e mbulimit të Ex/Im
2013	355.1	875.1	520.0		246.4
2014	468.7	928.6	459.9	-11.57	198.1
2015	494.4	951.5	457.1	-0.61	192.4
2016	491.8	1,130.6	638.8	39.75	229.9
2017	536.3	1,329.8	793.5	24.21	248.0

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (Nëntor, 2018)

Figura 8. Tregtia e jashtme në shërbime (mil. €)



3.3 Partnerët kryesor tregtarë të Kosovës

Kosova gjatë viteve 2013-2017 ka importuar mallra në përqindje të lartë nga vendet e CEFTA-së dhe BE-së. Marrëdhëniet tregtare të Kosovës realizohen në të shumtën me shtetet e BE-së dhe CEFTA-s, si pasojë e afërsisë gjeografike dhe marrëveshjeve të tregtisë së lirë, duke zgjeruar bazën e importit dhe eksportit nga/në këto shtete. Në vitin 2017, partner kryesor për eksport i Kosovës ishte Shqipëria, pasuar nga India, Serbia dhe Maqedonia sipas tabelës 9.

Tabela 9. Partnerët kryesorë të Kosovës në eksport të mallrave 2013-2017 (mil. €)

Eksporti	2013	2014	2015	2016	2017
CEFTA	104.5	127.1	123.7	144.3	183
Shqipëria	43.8	44	40.2	42	60.2
Serbia	14.5	27.3	32.3	41.3	48.2
Maqedonia	26.1	36	33.3	38.6	45.8
Bashkimi European	118.4	98.1	106	70	94.2
Gjermania	10.9	11.3	11.7	13.8	20.2
India	8.9	27.4	47	9.4	52.6

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018)

Në vitin 2017, Kosova ka importuar më së shumti produkte nga Serbia, pasuar nga Gjermania, Turqia dhe Kina sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 10.

Tabela 10. Partnerët kryesorë të Kosovës në import të mallrave 2013-2017 (mil. €)

Importi	2013	2014	2015	2016	2017
CEFTA	676.3	720.4	769.4	753.2	856.1
Serbia	285.4	368.2	382.1	387.6	449.9
Maqedonia	185	139.7	143.8	156.7	156.5
Bashkimi European	1083.2	1081	1112.9	1202.1	1312.2
Gjermania	252.6	273	290.9	342.9	378.5
Turqia	204.9	238.3	252.3	288.5	292.6
Kina	179.5	204.8	232.9	258.5	275.5

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018)

3.4 Projektionet e shkëmbimeve tregtare 2018-2020

Sipas vlerësimit të Ministrisë së Financave, të paraqitur në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, pritet që trendi ekzistues i shkëmbimeve tregtare të vazhdojë edhe në vitet 2018-2021. Më saktësisht, pritet të ketë trend rritës si në eksport të mallrave, poashtu dhe në import të mallrave, por të karakterizuar me rritje më të shpejtë të importit dhe rrjedhimisht të bilancit tregtar negativ (në vitin 2021 pritet që bilanci tregtar të arrijë shifrën prej -2,251 milion euro).


Kosova ka raport pozitiv të eksportit të shërbimeve në krahasim me importin e shërbimeve, më saktësisht 1,593 milion euro me 568 milion euro (apo në proporcion rreth 3:1 shërbime të eksportuara për shërbime të importuara). Eksportet për periudhën 2018-2021 llogaritet se do të arrijnë në rreth 26.5% të BPV-së, ndërsa importet parashihet të jenë rreth 54.5% të BPV-së, të dyja shifra të ngjajshme me ato të vitit 2017.²⁰

Tabela 11. Projektionet e eksportit dhe importit për vitet 2018-2021 (mil. €)

	2018		2019		2020		2021	
	Mallra	Shërbime	Mallra	Shërbime	Mallra	Shërbime	Mallra	Shërbime
Eksporti	401	1,404	421	1,461	448	1,524	468	1,593
Importi	3,129	532	3,337	545	3,500	556	3,744	568
Bilanci Tregtar	-1,856		-2,000		-2,083		-2,251	

Burimi: Ministria e Financave, KASH 2019-2021(Prill, 2018)

Figura 9. Projektionet e tregtisë së jashtme në mallra dhe shërbime për vitet 2018-2021 (mil. €)



²⁰ Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021

4 REMITANCAT

Kosova ka një numër të madh të qytetarëve të cilët jetojnë në vendet tjera në Europë, në Amerikë dhe më gjerë. Diaspora jonë ka kontribuar në faza të ndryshme të historisë së Kosovës dhe ka merita të mëdha për mirëqenien e shoqërisë kosovare si dhe në ndërtimin dhe zhvillimin e Kosovës. Roli i diasporës kosovare në zhvillimin ekonomik është i madh, qoftë nëpërmjet remitancave apo edhe përmes investimeve direkte që bëjnë në Kosovë.

Remitancat në Kosovë, në shumicën e rasteve përdoren për konsum dhe ndikojnë drejtëpërdrejtë në plotësimin e nevojave ditore të popullatës së vendit. Pasi që niveli i prodhimit në vend është mjaft i ulët, atëherë Kosova detyrimisht varet nga importi i produkteve përfshirë këtu edhe importin e produkteve ushqimore. Në këtë mënyrë, një pjesë e madhe e remitancave përdoren për konsum aktual si ushqim, veshëmbathje, shërbime komunale (35.4%), shpenzime tjera si pajisje shtëpiake, makina, dasma, etj. (24.8%), investime banimi - blerje apo renovim (19.6%), ndërsa shpenzimet në shkollim apo kujdes shëndetësor përbëjnë 10.6%. Mesatarisht në investime biznesore shpenzohen 3.9% të remitancave, ndërsa 3.7% të remitancave kursehen.²¹

Studimet në këtë fushë tregojnë se një pjesë e madhe e këtyre të ardhurave në shtetet në zhvillim shërbejnë për konsum aktual, duke kontribuar në zvogëlimin e disbalancit makroekonomik në Kosovë²². Poashtu, Kosova është renditur si ndër shtetet me përqindjen më të lartë të ndikimit të remitancave në BPV, në vitet 2014 dhe 2015 (në 10-përqindëshin e parë). Në vitin 2014, ndikimi i remitancave në BPV ishte 16.1%, ndërsa në vitin 2015, ndikimi ka rënë në 13%.²³

Pjesa tjetër e remitancave shërben për investime (në shkollim, kujdes shëndetësor, investime në banim/shtëpi apo biznese). Shkollimi shërben si përshpejtues për zhvillim ekonomik në të ardhmen (psh. studimet e bëra në disa shtete në zhvillim, tregojnë për rënie të numrit të nxënësve që braktisin shkollën e mesme për shkak të pranimit të remitancave, apo respektivisht rritjes së investimeve në shkollim). Pavarësisht mënyrës se si shpenzohen, remitancat ngritin nivelin e të ardhurave të pranuesve dhe njëkohësisht nivelin e konsumit, duke stimuluar rritjen ekonomike në një shtet, përmes efekteve multiplikuese (shumëzuese).

²¹ UNDP Kosovo Remittances Report 2012

²² "Remittances in Kosovo: Primarily an economic survival tool?" Group for Legal and Political Studies, 2017

²³ Migration and Remittances Factbook 2016, World Bank Group

Tabela 12. Remitancat 2013 - 2017 (mil. €)

Viti	Remitancat (mil. €)	% e rritjes (t/t-1)
2013	573.4	-
2014	622.3	8.5%
2015	665.5	6.9%
2016	691.0	3.8%
2017	759.2	9.8%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (2018)

Sipas të dhënave të publikuara nga BQK, remitancat kanë pasur një trend të rritjes në periudhën 2013-2017. Në vitin 2013 vlera e remitancave në Kosovë ishte 573.4 milion euro duke arritur në 691 milion euro në vitin 2016. Trendi pozitiv ka vazhduar edhe në vitin 2017, ku vlera e remitancave ka arritur në 759.2 milion euro apo 9.8% rritje në krahasim me vitin 2016.

Vendet kryesore nga të cilat vijnë vlera më e madhe e remitancave në Kosovë janë Gjermania, Zvicra, Italia, Austria dhe SHBA-ja. Nga totali i remitancave të dërguara në Kosovë në vitin 2017, nga Gjermania janë të pranuar 39.3% prej tyre, nga Zvicra 22.5%, nga Italia 4.4%, nga Austria 3.8% dhe nga SHBA 6.9%. Përqindja e pjesëmarrjes në totalin e remitancave të dërguara nga SHBA, nga 4.3% sa ishte në vitin 2013 është rritur në 6.9% në vitin 2017 ndërsa nga Austria ka rënë nga 5.9% në vitin 2013 në 3.8% në vitin 2017.

Tabela 13. Vendet kryesore nga të cilat vijnë remitancat në %

Viti	Gjermani	Zvicra	Itali	Austri	SHBA
2013	33.9	23.7	7.6	5.9	4.3
2014	36.3	22.5	4.9	3.7	6.2
2015	36.7	22.3	4.8	3.5	8
2016	37	22.6	5.2	3.6	6.8
2017	39.3	22.5	4.4	3.8	6.9

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (2018)

Në mënyrë që remitancat të kenë efekt më të lartë pozitiv në ekonominë vendore, ato duhet investuar, ndër tjerash në shkollim dhe përmes investimeve në biznese vendore për të zgjeruar bazën e produktivitetit vendor dhe rritjen e punësimit. Kursimi dhe investimi i remitancave në projekte afatgjata, do të mund të krijonte efektin e duhur në rritjen ekonomike në shtetet në zhvillim.

Përpos dërgimit të remitancave në Kosovë, diaspora kontribuon përmes shpenzimeve të drejtpërdrejta gjatë vizitës në Kosovë, pasi më shumë se gjysma apo 57.1% prej tyre raportojnë të kenë vizituar Kosovën së paku një herë në vit, përdërisa shumica prej tyre kanë raportuar që qëndrojnë në Kosovë nga dy javë deri në një muaj.²⁴ Arsyet se përse diaspora dërgon remitanca në Kosovë kryesisht qëndrojnë tek mbështetja financiare për familjarët e tyre ndërkohë që pjesa e mbetur është e dedikuar për blerje të patundshmërive, kursime, huazim familjarëve dhe miqëve, etj.

Sipas raportit të UNDP-së, fushat kryesore në të cilat diaspora investon janë blerja e patundshmërive për nevoja personale (59.8%), në biznese familjare (23.3%), në blerje të patundshmërive për shitje/qera (7.1%) dhe në shërbime (5.6%), ndërsa nuk është raportuar për investime kapitale të remitancave.²⁵ Diaspora duhet stimuluar përmes programeve të ndryshme në mënyrë që kursimet/investimet e tyre të orientohen në hapjen e bizneseve të cilat ndikojnë në zhvillim ekonomik të qëndrueshëm si dhe në uljen e normës së lartë të papunësisë.

²⁴ UNDP Kosovo Remittances Report 2012

²⁵ Ibid

5 INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë sipas të dhënave nga BQK janë të përbëra nga kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, si dhe nga instrumentet e borxhit. Vlera e IHD-ve në Kosovë në vitin 2017 arriti vlerën prej 255.4 milion euro. Krahasuar me vitin 2016, kjo vlerë në vitin 2017 është rritur për 16.1% (tabela 14).


Tabela 14. Investimet e huaja direkte në Kosovë 2013-2017

Viti	Në mil.€	% (t/t-1)
2013	280.2	22
2014	151.2	-46
2015	308.8	104
2016	220.0	-28.7
2017	255.4	16.1

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (Nëntor, 2018)

Sipas BQK-së, me rritje të vlerës u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, ndërsa investimet në instrumentet e borxhit shënuan rënie.

Figura 10. Investimet e huaja direkte në Kosovë 2013-2017



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (Nëntor 2018)


5.1 IHD sipas sektorëve

Në zbërthimin e strukturës së investimeve sipas sektorëve, me rritje gjatë vitit 2017 u karakterizua patundshmëria, qiradhënia dhe aktivitetet biznesore, që njëkohësisht përbëjnë dhe strukturën më të lartë të investimeve ndër vite, sektori i shërbimeve financiare dhe ndërtimtaria. Rënia më e theksuar ishte tek sektori i shërbimeve tregtare, energjetika, industria si dhe shërbimet tjera (figura 11).

Patundshmëria, qiradhënia dhe aktivitetet biznesore vazhdojnë të përbëjnë strukturën më të madhe të investimeve të huaja në Kosovë, me vlerë prej 187 milion euro gjatë vitit 2017. Njëkohësisht, ky aktivitet përbën 73% të vlerës së përgjithshme të investimeve në vitin 2017. Sektori i shërbimeve financiare ka shënuar rritje më të theksuar në krahasim me vitin paraprak duke arritur në vlerën prej 55 milion euro (nga 19 milion euro sa ishte në vitin 2016), industrisë në vlerë prej 5.7 milion euro (duke shënuar rritje prej 24% nga viti 2016).

Në strukturën e sektorëve tjerë, rënie në investime krahasuar me vitin paraprak ka shënuar sektori i ndërtimtarisë (me zvogëlim prej rreth 23 milion euro investime krahasuar me vitin paraprak), shërbimet tregtare (nga 14.5 milion euro në vitin 2016, në 10.3 milion euro në vitin 2017) dhe energjetika me rreth 4.4 milion euro më pak investime. Përkundër potencialit, investimet në sektorët strategjik të Kosovës sikurse bujqësia, minierat, energjetika mbesin të ulëta nga investitorët e huaj.

Figura 11. Struktura e investimeve në përqindje



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (Nëntor 2018)

5.2 Investimet sipas shteteve

Gjermania, Zvicra, Turqia, Austria dhe Mbretëria e Bashkuar janë shtetet që kanë investuar dhe vazhdojnë të jenë investitorët kryesorë në Kosovë. Gjermania gjatë vitit 2017 sipas BQK-së ka investuar 55.9 milion euro, Zvicra 50.6 milion euro, Turqia 29.5 milion euro, Mbretëria e Bashkuar 27.0 milion euro dhe Austria 20.3 milion euro. Bilanc pozitiv i trendit të investimeve ka qenë me shumicën e shteteve gjatë vitit të kaluar, si pasojë e rritjes së përgjithshme të trendit të investimeve. Investimet nga këto shtete ndër vite janë të paraqitura në tabelën më poshtë (tabela 15). Sipas trendit në vitet e përcjellura, koncentrimi i investimeve nga këto pesë shtete është mjaft i lartë dhe ka pasur trend të rritjes, nga 62% sa ka qenë në vitin 2013, në 72% në vitin 2017. Portfolio e investimeve të jashtme është mjaft e koncentruar dhe diversifikimi i investimeve të huaja mbetet në nivel jo të kënaqshëm, duke treguar se ende ka hapësirë për përmirësimin e ofertës dhe ngritjen e nivelit të investimeve nga shtetet tjera.

Tabela 15. Investimet neto sipas shteteve (mil. €)

Viti	IHD sipas viteve	Mbretëria	Gjermania	Turqia	Zvicra	Austria	5 shtetet	% nga IHD
		e Bashkuar						
	1	2	3	4	5	6	7(2+3+4+5+6)	8=7/1
2013	280.2	10.7	21.7	88.6	41.7	10.7	173.4	61.9
2014	151.2	-39.5	29.4	20.0	38.2	30.3	78.4	51.8
2015	308.8	26.6	45.3	55.4	72.9	33.5	233.7	75.6
2016	220.0	13.6	25.7	44.4	61.8	9.9	155.4	70.6
2017	255.4	27.0	55.9	29.5	50.6	20.3	183.3	71.7
Totali	1,215.6	38.4	178	237.9	265.2	104.7	824.2	

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (Nëntor 2018)



Figura 12. Investimet në vitet 2013-2017 sipas shteteve

Figura 12 është pasqyrë e investimeve dhe ndryshimeve në investime gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare sipas shteteve. Për shtetet të cilat kanë pasur rënie në investime, diferenca në mes të viteve është e shfaqur me ngjyrë të mbylltë, ndërsa për ato shtete të cilat kanë pasur ngritje në investime, diferenca është me ngjyrë të bardhë.

Rritja e IHD-ve shënon dhe rritjen e shkallës së ndikimit të IHD-ve në bruto produktin vendor të Kosovës dhe anasjelltas. Siç mund të shihet në figurën 13 më poshtë, ndikimi më i ulët i IHD-ve në BPV gjatë kësaj periudhe ishte në vitin 2014, ku përqindja ishte 2.8%. Ndërsa gjatë vitit 2017 mund të vërehet rritje në krahasim me vitin paraprak, ku prej 3.6% ndikimi i investimeve të huaja në BPV është rritur në 4.0%.

Figura 13. Ndikimi i IHD në BPV si përqindje

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (Nëntor 2018)

*y1 = në mil.€, y2 = në përqindje

Indikatorët e të bërit biznes 2019

Gjatë viteve të fundit, Kosova është përmirësuar dukshëm në rang listën e Bankës Botërore për lehtësinë e të bërit biznes, ku rankohet e 44-ta, përpara vendeve të rajonit si Shqipëria (63), Bosnja (89), Kroacia (58), Mali i Zi (50), dhe Serbia (48). Vetëm Kosova, Gjeorgjia dhe Moldavia janë tri ekonomitë me të ardhura të ulëta mesatare, të përfaqësuara në listën e top 50 shteteve për nga ky indikator. Përkundër kësaj, hulumtimet e fundit tregojnë se investitorët e huaj nuk janë më vetëm të interesuar në aspektet teknike të marrjes së lejes së ndërtimit apo operimit në ndonjë shtet. Ajo që në baraspeshë ndikon tek investitorët e huaj është faktori politik në shtet apo rëndësia e stabilitetit politik, funksionimi i mirëfilltë i gjyqësorit dhe dhomave ekonomike, popullata e shkolluar për të ju përshtatur nevojave të tregut, dhe faktorë tjerë të cilët nuk merren parasysh gjatë përgatitjes së raportit vjetor “Të bërit biznes”. Prandaj, është vërejtur tek shtetet si Kosova apo Maqedonia që përkundër përparimit të dukshëm në këtë rang listë, ka patur rritje të lehtë apo edhe rënie të investimeve në periudhën e fundit afatmesme ²⁶.

Tabela 16. Indikatorët e performancës “Doing business 2019”

INDIKATORËT E TË BËRIT BIZNES 2019	
Fillimi i Biznesit	13
Marrja e lejes së ndërtimit	100
Kyçja në rrjetin elektrik	113
Regjistrimi i pronës	37
Qasja në kredi	12
Mbrojtja e investitorëve nga minoritetet	95
Pagesa e tatimeve	44
Tregtia ndërkuftare	51
Zbatimi i kontratave	50
Zgjidhja e paaftësisë së pagesës (insolvenca)	50
Vlera e përgjithshme	44

Performanca e Kosovës është përmirësuar gjatë vitit të kaluar në indikatorët e marrjes së lejes së ndërtimit (100), pagesën e tatimeve (44) si dhe tregtia ndërkuftare (51). Në anën tjetër, mungojnë reforma në indikatorët në të cilët Kosova është renditur më dobët dhe kryesisht në ato të cilat faktori njerëzor ndikon në zgjatjen e procedurave burokratike. Në indikatorët për kyçje në rrjetin elektrik (113) apo mbrojtja e investitorëve nga minoritetet (95), nuk është shënuar përparim apo janë zhvilluar procedura që nuk kanë ndikuar në lehtësimin e tyre. ²⁷

²⁶ Doing Business Report 2018, World Bank Group

²⁷ Doing Business Indicator 2018, World Bank Group

Reformat të cilat ndikojnë në rritjen e transparencës dhe digjitalizimin e procedurave administrative, të cilat njëkohësisht zvogëlojnë por edhe përshpejtojnë afatin kohor për t'u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm, janë disa nga reformat të cilat rekomandohen për zbatim në funksion të përmirësimit të performancës. Poashtu, faktorët e jashtëm të cilët nuk përfshihen drejtpërdrejtë në indikatorët e Bankës Botërore si stabiliteti politik, qëndrueshmëria makrofinanciare, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, ngritja e cilësisë së shkollimit dhe inovacioni, kanë të njëjtin ndikim tek investitorët e huaj për të vendosur rreth investimit në një ekonomi.

6 INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT (IHÇK)

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) përdoret si matës zyrtar i inflacionit në vendin tonë, indikator i rëndësishëm për analizat makroekonomike dhe tregues i rëndësishëm i nivelit jetësor familjar. Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës (ASK), IHÇK nga muaji Janar 2016 publikohet me vitin bazë 2015=100. Llogaritjet e IHÇK-së realizohen duke u bazuar në matjet e një game të madhe të produkteve sipas një klasifikimi të përcaktuar nga Eurostat. ASK realizon kalkulimet dhe monitoron rreth 408 produkte, mbi 6000 çmime në pikat monitoruese, në të gjitha komunat kryesore të Kosovës.²⁸

Tabela 17. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) në %

	2013	2014	2015	2016	2017
Mesatarja vjetore (%)	1.8	0.4	-0.5	0.3	1.5

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018)

Sipas ASK-së, gjatë vitit të kaluar ngritja e çmimeve vërehet tek produktet si: bukë dhe drithëra (1.2%); mish (4.6%); perime (10.7%); pije alkoolike (3.6%); duhan (2.8%); përdorim i pajisjeve për transportin personal (11.4%), si pasojë e ngritjes së çmimit të naftës dhe benzinës; shërbimet për transport (5.8%) sektor në të cilin kanë ndikuar ngritja e çmimeve të biletave të transportit ajror; shërbime hoteliere (2.6%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2.2 për qind në IHÇK.

Ndërsa, kjo ngritje u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit: pemë (-11.7%); sheqer dhe ëmbëlsira (-7.0%); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perime (-1.1%); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-6.3%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.7%) në IHÇK.²⁹

²⁸ Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit 2002 -2017, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2018

²⁹ <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-tetor-2018>

7 KONKLUZION

Kosova është duke bërë hapa të sigurtë që të arrijë ekonomisht vendet e rajonit dhe Bashkimit European. Sipas analizës më lartë, Kosova prinë me normë të rritjes ekonomike, përkundër faktit që ka bruto produktin vendor me vlerën më të ulët në rajon. Kosova prinë me rritje ekonomike mesatarisht 4%, duke u renditur e para në rajon. Poashtu, parashihet një rritje konstante në vitet në vijim, deri në 5.3% në vitin 2021. Sidoqoftë, sa i përket shkëmbimeve tregtare të dhënat për periudhën e ardhshme 5-vjeçare tregojnë që ka vazhdimësi në ngecje, duke rezultuar në bilanc tregtar negativ. Ky bilanc është si rrjedhojë e bazës së ulët të eksportit dhe importit të lartë, i cili është vazhdimisht në rritje. Rritja e eksportit është ndër kategoritë në të cilën Kosova ka më së shumti nevojë për ndryshime pozitive.

Duke konsideruar numrin e madh të emigrantëve në Kosovë, vlera e remitancave ndër vite ishte konsiderueshëm e lartë, me një trend të vazhdueshëm të rritjes. Në vitin 2017, kjo vlerë arriti në 759.2 milion Euro (12% e BPV-së), që thekson rëndësinë e remitancave në ekonominë e vendit. Përderisa kjo vlerë e lehtëson konsumin e qytetarëve, duhet theksuar që deri më tani një përqindje e ulët e tyre është përdorur për investime. Sa i përket borxhit publik, Kosova ka një nivel të ulët krahasuar me vendet e rajonit dhe Eurozonës, mirëpo me një trend të rritjes, i cili ka arritur në 16.63% të BPV-së në vitin 2017 krahasuar me 8.94% të BPV-së në vitin 2013. Vlera e investimeve të huaja direkte në Kosovë është mjaft e paqëndrueshme, mirëpo tregon një korrelacion pozitiv me ekonominë e Eurozonës, në kuptimin që një rritje ekonomike në Eurozonë, korespondon me rritje të IHD-ve në Kosovë. Sa i përket remitancave dhe IHD-ve, Kosova ka një raport më të mirë me Zvicrën dhe Gjermaninë, ndërsa në shkëmbimet tregtare Kosova ka bashkëpunim më së shumti me shtetet e rajonit dhe Turqinë.

Projeksionet për rritjen ekonomike në eurozonë, me të cilën Kosova mbanë lidhje të ngushta ekonomike, për periudhën e ardhshme janë pozitive. Sipas parashikimeve të Komisionit European, rritja e plotë në vitin 2017 në të gjitha vendet e BE-së (rritje të tillë në të gjitha shtetet e BE-së nuk ka patur që nga kriza ekonomike financiare në vitin 2007), pritet të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme si pasojë e shpenzimeve të ulëta të financimit, përmirësimit të bilancit privat si dhe kushteve të përmirësuara në tregun e punës. Andaj rritja ekonomike në vendet e BE-së në vitin 2018 pritet të jetë 2.3%, ndërsa në vitin 2019 (me një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2018), pritet të arrijë në 2%.³⁰

³⁰ European Commission Spring Forecast Report 2018

Sigurisht, parashikimet duhet të merren me një dozë rezerve duke pasur parasysh tërheqjen e Britanisë së Madhe nga eurozona, vendim ky i cili mund të kenë ndikim potencial në ekonominë e BE-s në përgjithësi. Poashtu “lufta” tregtare e inicuar nga SHBA-të në fillim të vitit 2018, me imponimin e tarifave tregtare në çelik pritet të ketë ndikim në ekonominë globale.

8 REFERENCAT

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018), Indeksi i Harmonizuar i i Çmimeve të Konsumit 2002 -2017
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018), Statistikat e tregtisë së jashtme 2017
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018), Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2018), Llogaritë Kombëtare 2017
- Banka Botërore (2018), Doing Business Indicators Report 2019
- Banka Botërore (2018), GDP per capita (current US\$)
- <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD>
- Banka Botërore (2018), Kosovo Overview, <http://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>
- Banka Botërore (2016), Migration and Remittances Factbook 2016
- Banka Botërore (2018), Regular Economic Report, Spring 2018
- Banka Botërore (2018), Western Balkans Regular Economic Report: Spring 2018
- Banka Qendrore e Kosovës (2018), Raporti Vjetor 2017
- Banka Qendrore e Kosovës (2018), Statistikat, Importi dhe Eksporti i shërbimeve
- Banka Qendrore e Kosovës (2018), Statistikat, Investimet e Huaja Direkte
- Banka Qendrore e Kosovës (2018), Statistikat, Remitancat
- European Commission (2018), Spring and Autumn Report 2018
- Eurostat (2017), GDP per capita, consumption per capita and price level indices
- Eurostat (2018), General Government Gross Debt
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-175 për Borxhe Publike
- Group for Legal and Political Studies (2017), Remittances in Kosovo: Primarily an economic survival tool?
- Ministria e Financave (2017), Të dhënat tre-mujore mbi borxhin e përgjithshëm – tremujori i katërt 2017
- Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020
- Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021
- Ministria e Financave (2018), Programi i borxhit shtetëror 2019-2021
- UNDP (2012), Kosovo Remittances Report

ANEKS

1. Shkëmbimet tregtare

Metodat e kalkulimit të rritjes vjetore:

$$\text{Rritja vjetore} = ((T_n / T_1) * 100) - 100 \quad \text{ose} \\ (T_n - T_1) / (T_1) * 100$$

$$\text{Shkalla e përbërë e rritjes vjetore} = ((T_n / T_1)^{(1/n)} - 1) * 100$$

T_n = vlera e fundit

T_1 = vlera fillesatre

n = periudha